



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/79


Datë: 15.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkriptit nga mbledhja 75 e Qeverisë e Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/79

Datë: 15.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961).
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/79

Datë: 15.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për zbatimin e procedurave qendrore të prokurimit publik.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/79

Datë: 15.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 dhe 50 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës themelon Këshillin e Ekspertëve (në tekstin e mëtejme Këshilli) në këtë përbërje:
  - 1.1. Përfaqësues nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kryesues;
  - 1.2. Përfaqësues nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
  - 1.3. Përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, anëtar;
  - 1.4. Përfaqësues nga Ministria e Financave, anëtar;
  - 1.5. Përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, anëtar;
  - 1.6. Përfaqësues nga Zyra Kryeministrit, anëtar;
2. Këshilli sipas pikës 1. të këtij vendimi ofron këshilla profesionale për Qeverinë e Republikës së Kosovës lidhur me kërkesat e parashtruara bazuar në nenin 8 dhe 14 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, përkatësisht për të gjitha kërkesat për shpronësim të pronave private për interes të subjekteve private.
3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të formojë Sekretariatit e Këshillit, i cili do të jetë i ngarkuar me organizimin e takimeve dhe përgatitjen e dokumentacionit përkatës sipas agjendës së Këshillit.
4. Këshilli është i obliguar që brenda afateve ligjore t'i shqyrtojë kërkesat sipas pikës 2. të këtij vendimi dhe t'i rekomandojë Qeverisë me përfundimet e arritura.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/79

Datë: 15.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti mbi Planifikimin dhe Implementimin e "Klauzolës për Investime".
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për informim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/79

Datë: 15.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet lista e përbashkët e mallrave me përdorim ushtarak, të cilat i nënshtrohen kontrollit shtetëror të importit dhe eksportit.
2. Ngarkohet Departamenti për Mallra Strategjike në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe Komisioni për licencimin e mallrave dhe shërbimeve strategjike për zbatimin e këtij vendimi.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e bashkëngjitur.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/79

Datë: 15.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për bashkëpunim Ndërkufitar, në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.
2. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që të zhvillojë negociata me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes së lartcekur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/79

Datë: 15.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15 paragrafi 2 të Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Punëve të Brendshme për rialokimin e mjeteve financiare në shumë prej 300.000 (treqind mijë) euro.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga nën programi Agjencia për Menaxhimin Emergjent me kod 32700, projekti "Ndërtimi i objektit të njësisë së shërbimit të zjarrefikjes dhe shpëtimit në Zveçan, si dhe renovimi i objekteve të këtyre njësive në Leposaviq, Zubin Potok dhe Qendra operative Emergjente (QOER) 112 në Mitrovicë" me kod 14964. Këto mjete kalojnë në të njëjtin nën program, Agjencia për Menaxhimin Emergjent me kod 32700, në projektin "Furnizim me uniforma për zjarrfikës" me kod 14401.
3. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave obligohen për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/79

Datë: 15.03.2016


Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni për hartimin e Projektligjit për Trepçën (në tekstin e mëtejme: Komisioni)
2. Anëtarë të Komisionit, emërohen:
  - 2.1. Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik - kryesues;
  - 2.2. Hajredin Kuçi, ministër i Drejtësisë - anëtar;
  - 2.3. Lubomir Mariq, ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal - anëtar;
  - 2.4. Ahmet Tmava, drejtor i Trepçës - anëtar;
  - 2.5. Petrit Gashi, kryesues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit - anëtar;
  - 2.6. Ranko Djokic, anëtar i Bordit të AKP-ës - anëtar;
  - 2.7. Naser Peci, dekan i Fakultetit të Gjeoshkencave - anëtar;
  - 2.8. Përfaqësues i Sindikatës së Pavarur të Trepçës - anëtar;
  - 2.9. Minir Dushi, ASHAK - anëtar;
  - 2.10. Shyqri Kelmendi, Profesor - anëtar;
  - 2.11. Ilaz Ramajli, njohës i çështjeve pronësore - anëtar;
  - 2.12. Ferat Shala, ish drejtor i Trepçës - anëtar;
  - 2.13. Besim M. Kajtazi, drejtor i Zyrës Ligjore ZKM - anëtar;
  - 2.14. Salvador Elmazi - drejtor i Departamentit të Buxhetit Qendror MF - anëtar;
  - 2.15. Dukagjin Avdyli - drejtor i Departamentit të Drejtës së BE-së - anëtar;
  - 2.16. Alban Collaku - drejtor i Departamentit Ligjor MZHE - anëtar.
3. Me qëllim të kryerjes efikase të aktivitetit të tij, Komisioni mund të formojë grupe punuese të përkohshme si dhe mund të angazhojë ekspertë nga fusha e qeverisjes korporative.
4. Në punën e tij, Komisioni mund të shfrytëzojë mbështetjen profesionale të institucioneve dhe organizatave përkatëse vendore dhe ndërkombëtare.
5. Komisioni është i obliguar që për punën e tij t'i raportojë Qeverisë kurdo që kërkohet raport për ecurinë e punës së Komisionit.

6. Komisioni është i obliguar që Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik t'ia paraqesë Projektligjin më së voni në afat prej dy muaj nga dita e nënshkrimit të këtij vendimi.
7. Ministria e Zhvillimit Ekonomik obligohet për sigurimin e kushteve materiale, teknike dhe kushteve tjera për punën e këtij Komisioni.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/79

Datë: 15.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti i Ministrit të Financave mbi Performancën e të Hyrave dhe Shpenzimeve Buxhetore.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 12/79

Datë: 15.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 129 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Për të gjitha prokurimet e centralizuara të Qeverisë së Republikës së Kosovës, bëhet i obligueshëm përdorimi i prokurimit elektronik, duke filluar nga data 01.04.2016.
2. Për të gjitha organizatat buxhetore të nivelit qendror, bëhet i obligueshëm përdorimi i prokurimit elektronik, duke filluar nga data 01.09.2016.
3. Përdorimi i prokurimit elektronik bëhet i obligueshëm për të gjitha organizatat buxhetore në Republikën e Kosovës nga data 01.01.2017.
4. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik dhe të gjitha organizatat buxhetore obligohen për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendim hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë